

V E N D I M
Nr.329, datë 12.7.1999

**PËR PROCEDURAT E TENDERIT PËR ZGJEDHJEN E INVESTITORËVE STRATEGJIKË
DHE PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË
SHOQËRITË TREGTARE TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

I.TË PËRGJITHSHME

1. Format e tenderit, të hapur ose të kufizuar, kriteret e zgjedhjes së investitorit strategjik, si dhe kriteret e vlerësimit të ofertave të tyre përcaktohen, rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave.

2. Procedurat e tenderit realizohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe privatizimit nën mbikëqyrjen e Kompanisë Konsulente, me të cilën ka kontraktuar për procesin e privatizimit të shoqërive, që veprojnë në sektorët e rëndësishëm të veçantë të ekonomisë.

3. Në rastin e tenderit të hapur të gjithë investitorët e interesuar ftohen të paraqesin shprehjen e tyre të interesit. Ndërmjet investitorëve pjesëmarrës zgjidhen investitorët e ftuar për të paraqitur ofertat e tyre. Në rastin e tenderit të kufizuar vetëm investitorët e ftuar drejtpërdrejt nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit paraqesin ofertat e tyre. Investitorët, që marrin pjesë në tender, duhet të jenë vetëm persona juridikë, vendas apo të huaj.

4. Procedura e tenderit nuk do të zbatohet për rastet e mëposhtme:

- Për transferimin e aksioneve ish-pronarëve të truallit të shoqërisë që privatizohet;
- Për transferimin e aksioneve punonjësve të shoqërisë që privatizohet;
- Për transferimin e aksioneve publikut.

5. Paketat e aksioneve të përmendura më sipër do të përcaktohen në përputhje me ligjin për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit për secilën shoqëri që privatizohet dhe do të llogariten në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, kapitulli I, pikat A, B dhe C, ndryshuar me akte të tjera ligjore.

II. PROCEDURAT

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, të përcaktuar në pikën 1, kapitulli I të këtij vendimi, për privatizimin me tender të aksioneve të shoqërisë që privatizohet, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me asistencën e Kompanisë Konsulente, nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe të kriterëve dhe të pikëve të vlerësimit të ofertave.

2. Dokumentacioni i nevojshëm përgatitet nga shoqëria që do të privatizohet, nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe nën mbikëqyrjen e Kompanisë Konsulente.

3. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit garanton dhënien e të njëjtit informacion për të gjithë investitorët e interesuar.

III. FTESA PËR TENDER

1. Një njoftim publik botohet në dy gazeta me qarkullim ndërkombëtar, në 3 (tre) numra të njëpasnjëshëm dhe do të bëhet me afishe në zonën pranë selisë së shoqërisë tregtare që privatizohet, si dhe nëpërmjet letrave, telefaksit etj.

2. Njoftimi publik përfshin:

- a) emrin e shoqërisë dhe selinë e saj;
- b) veprimtarinë e biznesit;
- c) shumën e aksioneve të shoqërisë që privatizohet (vlerën nominale dhe përqindjen në kapital);

ç) elementët që duhen përfshirë dhe kushtin për paraqitjen (vendi, mjetet e dorëzimit dhe afati përfundimtar) e shprehjes së interesit.

3. Me marrjen e shprehjes së interesit, ftesa e tenderit do t’u shpërndahet, jo më pak se 30 ditë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, vetëm kandidatëve që përmbushin kërkesat e mëposhtme

:

- a) kanë mundësinë e duhur profesionale, teknike dhe organizative;
- b) kanë personelin, burimet financiare dhe reputacionin e duhur;
- c) janë personalitete juridike sipas ligjit;
- ç) kanë aftësi paguese, nuk kanë falimentuar apo nuk janë në procedurat e likuidimit.

4. Tenderi, duke qënë në varësi të situatës së veçantë të çdo shoqërie që privatizohet, mund të strukturohet në një apo dy faza. Në rastin e tenderit me dy faza, përfshihet edhe paraqitja e një oferte paraprake, jo të detyrueshme, e ndjekur nga përzgjedhja dhe paraqitja e një oferte tjetër të detyrueshme për kandidatët e përzgjedhur.

5. Ftesa për tender përfshin:

- a) emrin e shoqërisë dhe selinë e saj;
- b) shumën e aksioneve të shoqërisë që privatizohet;
- c) përshkrimin e procedurës së tenderit;
- ç) kopjen e ligjit përkatës për formën dhe strukturën e formulës së privatizimit për shoqërinë

që privatizohet;

d) deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit për dokumentacionin e tërhequr;

dh) udhëzimet për strukturimin e ofertës, kushtet për paraqitjen e saj (vendi, mjetet e dorëzimit dhe afati përfundimtar), kohën e hapjes dhe të vlerësimit të ofertave;

e) kushtet për paraqitjen (vendi, mjetet e shpërndarjes dhe afati i fundit), hapjen dhe vlerësimin e ofertave;

ë) specifikimet për garancinë e tenderit (përcaktuar në kapitullin IV të këtij vendimi);

f) afatin e vlefshmërisë së ofertave;

g) adresën e zyrtarit përgjegjës për informacione të mëtejshme.

6. Në rastin e tenderit të kufizuar, ftesa për tender do t'u shpërndahet jo më pak se 5 (pesë) investitorëve.

7. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit do t'i pajisë kandidatët e ftuar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Këshillit të Ministrave dhe urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për privatizimin me tender të aksioneve të shoqërisë që privatizohet;

b) vendimin e regjistrimit në "Regjistrin e shoqërive tregtare", të shoqërisë që privatizohet;

c) aktin e themelimit të shoqërisë;

ç) statutin e shoqërisë;

d) bilancin e vërtetuar të 3 viteve të fundit, nëse ka;

dh) kopjen e raporteve zyrtare të ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë;

e) memorandum informues për shoqërinë;

ë) dokumentacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm (psh projektin e marrëveshjes së shitjes dhe blerjes, që rregullon transferimin e aksioneve, kuadrin ligjor të sektorit ekonomik ku shoqëria operon etj.).

8. Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për tender, kandidatët mund të marrin një kopje të dokumentacionit të sipërpërmendur.

IV. GARANCIA E TENDERIT DHE DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT

Kandidati paraqet:

a) një garanci bankare prej 20 përqindësh të vlerës nominale të aksioneve të ofruara me tender, në favor të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

b) vendimin e regjistrimit në "Regjistrin e shoqërive tregtare" ose dokumentin e njëvlefshëm, të lëshuar nga autoriteti përkatës i vendit;

c) dokumentet e tjera, nëse ka, siç përcaktohet në udhëzimin për tenderin.

V. PARAQITJA E OFERTAVE

1. Kandidatët do t'i paraqesin ofertat e tyre në përputhje me udhëzimet dhe kushtet e përcaktuara në ftesën për tender.

2. Kandidatët do të paraqesin vetëm një ofertë.

3. Oferta përfshin angazhimet e mëposhtme:

- pranimin prej kandidatit të kushteve të përcaktuara në ftesën për tender;

- pranimin prej kandidatit të detyrimeve që rrjedhin nga fitimi i tenderit.

4. Të gjitha shpenzimet e kryera nga kandidatët, për përgatitjen e ofertave të tyre, nuk rimbursohen.

VI. KONFIDENCIALITETI

1. Kandidati ruan konfidencialitetin për përmbajtjen e tenderit, si dhe të të gjitha fakteve, informacioneve dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Nëse ndonjë kandidat nuk përmbush detyrimin e konfidencialitetit për tenderin, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e quan të pavlefshme ofertën e tij.

3. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ruan konfidencialitetin për përmbajtjen e ofertave.

VII. KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave do të jetë Komiteti i Konsulencës dhe i Transparencës, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 25.9.1998, si dhe një përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP).

2. Nuk duhet të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave:

- a) një person përfaqësues i ndonjë institucioni apo organizate që është kandidat për tender;
- b) punëdhënës ose nëpunës, të cilët kanë marrëdhënie kontraktore me shoqërinë që privatizohet dhe me ofruesin;
- c) ortak aksioner i një shoqërie, si dhe anëtar i një ndërmarrjeje apo biznesi ligjor, që paraqitet si kandidat.

3. Çdo person pjesëmarrës në komisionin e vlerësimit të ofertave (përfshirë përfaqësuesit e Kompanisë Konsulente), duhet të deklarojë se nuk ka lidhje gjaku, krushqie apo interesash me pjesëmarrësit në tender.

4. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të ruajnë konfidencialitetin për përmbajtjen e ofertave.

VIII. HAPJA E ZARFAVE TË VULOSUR DHE VLERËSIMI I OFERTAVE

1. Zarfat e vulosur, që përmbajnë ofertat, do të hapen nga komisioni i vlerësimit të ofertave në datën dhe në vendin e treguar në ftesën për tender.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson ofertat në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për shoqërinë që privatizohet dhe me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Pas vlerësimit të secilës ofertë, komisioni i vlerësimit të ofertave harton një raport për vlerësimin e bërë për ofertat. Ky raport përmban :

- a) objektin e tenderit, paketën e aksioneve që nxirren për shitje;
- b) një përmbledhje të shkurtër të procedurës, numrin e ofertave të marra;
- c) një përmbledhje të ofertave të marra;
- ç) kriterin kryesor të vlerësimit të ofertave dhe mendimin për ofertat individuale;
- d) kriteret e përcaktimit të çmimit të blerjes;
- dh) një vlerësim përmbledhës të rezultatit të procedurës së tenderit së bashku me renditjen e kandidatëve, sipas vlerësimit të bërë në ofertat e tyre.

XI. DEKLARIMI I PAVLEFSHMËRISË SË OFERTËS DHE I MOSSUKSESIT TË TENDERIT

1. Një ofertë deklarohet e pavlefshme nëse :

- a) kandidati nuk ka dhënë garancitë e nevojshme;
- b) kandidati ka shkelur detyrimin e konfidencialitetit;
- c) kandidati nuk ka plotësuar ndonjë kërkesë të ftesës për tender.

2. Tenderi deklarohet i pasuksesshëm nëse :

- a) asnjëra nga ofertat e paraqitur nuk përmbush kërkesat e ftesës për tender;
- b) Këshilli i Ministrave vendos ta mbyllë tenderin.

X. FITUESI I TENDERIT

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave i paraqet Këshillit të Ministrave raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të fituesit të tenderit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit lidh kontratën e shitjes me të.

2. Negocimet me kandidatët dhe kontrata e shitjes me fituesin e tenderit do të bëhen me asistencën e Kompanisë Konsulente.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko